


## Detyra 1: Simulimi i hedhjes së dy zareve në Excel (5 pikë)

Detyra ka për qëllim që ju të mësoni të ndryshoni madhësinë e shkronjave, stilet e shkronjave, te vendosni vija, korniza (border), ndryshoni ngjyrat e sfondit, përdorimin e funksioneve të gatshme si dhe kushtit if, etj. Duke automatizuar në Excel hedhjen e dy zareve.

1. Selektoni qelizat B2:J9. Ngjyroseni me të gjelbër dhe me kornize te zeze. Zgjidhni fontin wingdings, që këto germa të duken si pika me font 28.
2. Vendos funksionin RANDBETWEEN(1,6) në qelizën C2.
3. Në qelizat C3 dhe E5 shkruani formulat që nëse ne rrokullisim zaret dhe kemi vlerat 2, 3, 4, 5 ose 6, këto qeliza duhet të përmbajnë një pikë. Ngjyroseni me të verdhë.
4. Ne qelizat C5 dhe E3, shkruani formulat që nëse ne rrokullisim zaret dhe kemi vlerat 4, 5 ose 6, këto qeliza duhet të përmbajnë një pikë. Ngjyroseni me të kuqe.
5. Në qelizat C4 dhe E4, shkruani formulën që nëse ne rrokullisim zaret dhe kemi vlerën 6, këto qeliza duhet të përmbajnë një pikë. Ngjyroseni me blu.
6. Në qelizën D4, shkruani formulën që nëse ne rrokullisim zaret dhe kemi vlerën 1,3,5 kjo qelizë duhet të përmbajnë një pikë. Ngjyrosini me gri.
7. Kopjoni range-in C2:E5 dhe paste tek G2:I5.
8. Ndryshoni ngjyrën e shkronjave të qelizës C2 dhe qelizës G2 në të gjelbër.
9. Për te vendosur një buton komande fillimisht duhet te aktivizoni developer tek **File Menu, Options, Customize Ribbon**, klikoni tek developer ne menyne **Main Tabs** dhe shtypni **OK**.
10. Më pas tek menyja Developer, zgjidh tek Controls, insert Controls, Form Controls, Button dhe vendoseni ne Excel (drag e drop).
11. Ndryshoni emrin nga button 1 në Hidhni Zaret.
12. Klik me të djathtën e mautin mbi butonin e vendosur dhe zgjidhni assign Macro. Zgjidh butonin Edit dhe shkruaj në editorin që ju del sheet1.calculate, si në figurën e mëposhtme.



13. Detyrën ruajeni me emër: Detyre1\_Emer\_Mbiemer duke zgjedhur tipin e filet excel macroenabled workbook.

14. Rezultati ne fund duhet t'ju dalë si më poshtë:

